

RAPORT I AUDITORES TE PAVARUR  
PER AUDITIMIN LIGJOR TE FONDEVE TE PERFITUAR DHE TE SHPENZUARA  
FUSHATA ZGJEDHORE PER KUVENDIN E SHQIPERISE 2013  
PERIUDHA 23.06.2013

---

RAPORTI I AUDITIT TË PAVARUR PËR QËLLIME TË VEÇANTA  
PËR AUDITIMIN E FONDEVE TË PËRFITUARA DHE TË SHPENZUARA  
NGA PARTIA  
“Fryma e Re Demokratike”

Tirane më, 05 Shtator 2013

## Tabela e përmbajtjes

RAPORTI I VEÇANTË I AUDITIT TË PAVARUR  
PASQYRA E TË ARDHURAVE (Financimet dhe Donacionet)  
PASQYRA E SHPENZIMEVE (Përdorimi i fondeve sipas destinacionit)  
INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

### Referencat ligjore:

Për kryerjen e këtij misioni jemi mbështetur në përputhje me:

- Standartet Ndërkombëtare të Auditimit me referencë të veçantë SNA 800.
- Ligjin nr.10019.datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"
- Ligjin nr.10091.datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe Kontabilistit të Miratuar"
- Ligjin Nr. 9228 datë 29.04.2004 „Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare“
- Çdo dokument ligjor të marrë pranë Partisë "Fryma e Re Demokratike".

# **RAPORT I AUDITUSIT MBI ANGAZHIMET E AUDITIMIT PËR QËLLIME TË VEÇANTA.**

## **MBI AUDITIMIN E SHPENZIMEVE TË PARTISË “Fryma e Re Demokratike”**

**Adresuar : KOMISIONIT QËNDROR ZGJEDHOR**

### **Të nderuar zotërinj**

Unë, Vullnetare Hoxha ( Çela) në cilësinë e Ekspertes Kontabël të Autorizuar (Auditor i pavarur) jam caktuar me Vendimin e dates 02.08.2013 të Komisionit Qendror te Zgjedhjeve, si dhe Kontratës së Shërbimit nr.6477 të dates 12.08.2013, për kryerjen e auditimit e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhoreper zgjedhjet parlamentare te kuvendit te Shqiperise të Partisë “Fryma e Re Demokratike”.

Ne kemi audituar pasqyrat bashkalidhur që lidhen me financimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore që fillon në datë 23.06.2013.

Përgatitja e këtyre pasqyrave është përgjegjësi e drejtusve të Partisë “Fryma e Re Demokratike”.

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra bazuar në auditimin tonë.

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit, me referencë të veçantë SNA 800 (raporti i auditorit për angazhime auditimi me qëllime të veçanta).

Këto standarte kërkojnë që ne të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të zotëruar siguri te arsishme, se këto pasqyra nuk përmbajnë anomali materjale. Auditimi përfshin shqyrtimin, mbi bazën e testeve, të fakteve që mbështesin shumat dhe deklarimet në pasqyrat financiare të arkëtim-pagesave.

Auditimi përfshin gjithashtu, vlerësimin e parimeve të kontabilitetit të ndjekura dhe vlerësimet e rëndësishme të bëra nga drejtimi, si edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrës së arkëtimit-pagesave.

Ne çojmë se auditimi ynë përbën një bazë të arsyeshme për të shprehur opinionin tonë. Politika kontabël e ndjekur nga ana e subjektit zgjedhor Partia “Fryma e Re Demokratike” është të përgatisë pasqyrat bashkalidhur mbi bazën e arkëtimit dhe pagesave. Mbi këtë bazë, e ardhura është njohur në momentin e arkëtimit dhe shpenzimet në momentin e pagesave.

Për mendimin tonë, pasqyrat bashkalidhidhur japin një pamje të vërtetë e të sinqertë të fondeve të arkëtuara dhe të shpenzuara nga subjekti zgjedhor Partia “Fryma e Re Demokratike” gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet parlamentare për në kuvendin e Shqipërisë të zhvilluara me datë 23.06.2013, në përputhje me bazën e arkëtimit dhe pagesave, siç përshkruhet në shënimet bashkalidhur.

Dokumentat që justifikojnë shpenzimet e mesiperme sipas natyres janë pjesërisht të rregullta dhe në përputhje me kërkesat e përcaktimet e bëra në pikën 3 tënenit 90 të ligjit nr.10019 datë29.02.2008 \*Kodi Zgjedhore i Republikës së Shqipërisë\*. Auditimi i shpenzimeve u realizua në analize të tyre në krahasim me dokumentin justifikues të paraqitur nga subjekti zgjedhore.

Raporti u hartua mbështetur në pasqyrat e të ardhurave e shpenzime dhe në pasqyrën e fondeve të përfituara në fushatën zgjedhore nga persona fizik e juridik për Partinë “Fryma e Re Demokratike”.

**Eksperte Kontabël e Regjistruar  
Vullnetare Hoxha (Çela)**

**Tiranë më, 05 Shtator 2013**

Adresa Rr. “Komuna e Parisit” Kulla nr. 4, Tiranë.

Cel.0682087442,

Tel zyre 2445486

E-mail:vullnetarecela@hotmail.com

**PARTIA “Fryma e Re Demokratike”**

**PASQYRA E ARKËTIMEVE PAGESAVE TË BËRA PËR FUSHATËN ZGJEDHORE**

<b>Te ardhurat dhe shpenzimet</b>	<b>Shuma</b>
<b>A- Te Ardhurat</b>	
Fondi financiar nga buxheti për fushatën zgjedhore	0
Fondi i dhënë në momentin e krijimit partisë	5,000
Fonde të dhuruara nga persona fizik për fushatë	4,177,830
<b>Fonde të përftuara nga persona Juridik për fushatë</b>	
<b>Totali të ardhurave, burimeve, (arkëtimeve)</b>	<b>4,182,830</b>
<b>B- SHPENZIME PËR FUSHATËN(deri më 23.06.2013)</b>	
1- Hapësire publicitare	
2- Shpenzime telefonike e postare	
3- Postera	1,334,830
4- Shtypshkrime	574,470
5- Stampime për publicitet	412,500
6- Qera ambjenti e zyre.	517,500
7- Të tjera	1,334,250
<b>Totali i shpenzimeve</b>	<b>4,182,830</b>

Gjendje ne arke

5.530

Gjendje ne banke

3,750

KRYETARI

BAMIR TOPI

## **TË DHËNA TË PËRGJITHSHME MBI SUBJEKTIN ZGJEDHOR**

Subjekti zgjedhor Partia “Fryma e RE Demokratike” e ka fituar zotësinë juridike për të vepruar, me vendim të Gjykatës së Rrethit Tiranë. Subjekti është i regjistruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë me Nipt.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të Ligjit Nr. 8580 datë 17.02.2000

“Për Partitë politike” neni 9, 10, 11 e të tjerë.

Qëllimi dhe objektivat e kësaj Partie gjejnë pasqyrim të qartë në Programin dhe Statutin e saj.

Subjekti zgjedhor Partia “Fryma e RE Demokratike” është një bashkim politik i qytetarëve shqiptarë e cila e ushtron veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Qendra e Partisë “Fryma e RE Demokratike” është në Tiranë.

Selia e Partisë “Fryma e RE Demokratike” është te rruga “Gorge Bush”, Tiranë.

### **Objekti i veprimtarisë :**

Qëllimi i Partisë “Fryma e RE Demokratike” është të forcojë eksperiencën politike demokratike në Shqipëri duke promovuar vlera demokratike.

Burimet e financimit janë :

- Buxheti i Shtetit financiar për fushatë zero (0) lekë.

-Kuotat e antaresise jane lekë.

-Si dhe burime të tjera të ligjshme sipas legjislacionit shqiptar. Zero.(0)

Burimet financiare jan përdorur drejtpërsëdrejti për të realizuar qëllimet dhe objektivat e subjektit zgjedhor.

Organet e Partisë Fryma e Re Demokratike në nivel qendror janë:

Asambleja Kombëtare;

Këshilli Kombëtar;

Bordi Drejtues;

Kryetari i Partisë;

Kryetar është zgjedhur Z. Bamir Topi.  
Partia ka vulën, logon, flamurin dhe stemat e saj.

## **1. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE DHE RREGULLAVE KRYESORE KONTABËL**

### **a. Mënyra e Prëgatitjes së Pasqyrave Financiare.**

Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet e tyre materiale, në përputhje me Normat Kombëtare të Raportimit Financiar, të cilat përfshijnë rregullat e përcaktuara në ligjin Nr. 9228 datë 29.04.2004 „Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare,“ të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Pasqyrat e paraqitura në raport janë shprehur në monedhën vendase në Lekë .

### **a. Rregullat për vlerësimin e të ardhurave dhe shpenzimeve.**

Të ardhurat regjistrohen sipas masës së realizimit të tyre nga kuotat e antaresise dhe përdorimi i tyre është sipas planit të buxhetit të financuar.

#### **Të Ardhurat.**

**Të ardhurat** janë të pasqyruara mbi bazën e arkëttimeve të burimeve të financimit të vëna në dispozicion të Partisë “Fryma e RE Demokratike”. Këto arkëtime janë bërë në arkë, në vlerën lekë që janë kuotat e antaresise konform rregullave të cilat tërësisht janë përdorur për fushatën zgjedhore të 23.06.2013.

**Detyrimet, ose Shpenzimet** janë njohur dhe pasqyruar mbi bazën e faturave tatimore, mandat arktimëve dhe mandat pagesave dhe dokumentave orgjinale kontabël.

Masa e shpenzimeve të kryera është e vogël dhe është e lidhur me burimet që gjithashtu ishin të vogla.

Të gjitha shpenzimet janë bërë nga arka dhe jo nëpërmjet llogarisë bankare, megjithëse shumat e paguara janë më të vogla se kufiri i vënë nga organet fiskale dhe që nuk përbën shkelje. Do të ishte mirë që në të ardhmen veprimet të kryhen nëpërmjet llogarisë bankare.

Sa me sipër për mënyrën e pasqyrimin të dhenave për përfitimet dhe shpenzimet

e fondeve te fushates theksoj se ka mangesi ne mbajtjen e dokumentacionit.  
Rekomandoj qe ne te ardhmen te ndryshoje praktika sidomos ne lidhje me shpenzimet per te cilat duhet te behen me fatura te rregullta sipas Ligjeve fiskale dhe Ligjit "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Fianciare". Pasqyra e meposhtme eshte e njejte me pasqyren qe subjekti na ke vene ne dispozicion.

Eksperte Kontabel e Rregjistruar

Vullnetare Çela (Hoxha)

Tiranë më, 05 Shtator 2013